

REZYME

Ky punim diplome me titull “Jugosllavia: Nga Monarkia te Federata – Historia e krijimit, funksionimit dhe shpërbërjes” paraqet një studim gjithëpërfshirës se si u formua Jugosllavia, mënyra në të cilën ajo funksionoj, dhe shkaqet që dërguan në shpërbërjen e saj. Ky punim duke qenë i ndërtuar nga burimet arkivore dhe literatura relevante, na ndihmon që ti hedhim një vështrim më të saktë temës në fjalë. Duke qenë se punimi mundohet të japë një qasje të re historiografike, ai në vetëvete përmban elemente të rëndësishme që karakterizuan shtetin e Jugosllavisë, dhe një trajtim të veçantë të një teme aq të përgjithshme, mirëpo shumë komplekse. Tema është përgaditur me kujdes të madh që ti ofroj lexuesit një pikëpamje të përgjithshme mbi atë që kishte qenë dhe duke parë prirjet e historiskruesve nga vendet e rajonit që mundohen ta përshkruajnë atë segment të historisë, i cili përmbanë një trajtesë të njëanshme dhe të veçantë ndaj një grupi të caktuar etnik, studimi jep një ndjenjë gjithëpërfshirëse dhe shumë dimensionale.

Punimi është i organizuar dhe i ndarë në katër kapituj, ku secili prej tyre ofron një strukturë që mundëson shtjellimin e pjesëve të veçanta të temës së trajtuar.

Në kapitullin e parë, trajtohen ngjarje me rëndësi të madhe botërore që mundësuan në krijimin e shteteve të reja në Evropë, ndër to dhe Jugosllavia, dhe fillet e organizimeve të sllavëve të jugut për të formuar një shtet përbashkues. Ndarja e territoreve të banuara me sllavë mes perandorive të fuqishme evropiane në Gadishullin Ballkanik, kishte mundësuar në krijimin e ndasive midis popujve të përafërt kulturalisht, që në fillim nuk do të përbënin ndonjë problem deri në krijimin e shtetit të tyre, ku dallimet në mënyrën e organizimit politik, ekonomik, e mbi të gjitha atij shoqëror do të kishin pasojat e veta. Mbarimi i Luftës së Madhe kishte bërë që shuarja e këtyre perandorive ti linte hapsirë funksionimit të shteteve kombëtare në Rëndin e Ri Botëror, që pavarësisht politikës së brendshme, shekulli i XX do të sillte ngjarje që do të sfidonin formacionet e reja politike. Funksionimi i një mbretërie parlamentare do të pamundësohej nga tendenecat e mbretit dhe një popullsie shumicë për të dominuar mbi të tjerët, duke sjellur diktaturë dhe një krizë politike që do të karakterizohej nga një rënie e qeverive dhe ndërrim i aleancave historike. Periudha midis dy luftërave botërore ishte një tregues i madh sesa ishte e vështirë funksionimi i një shteti heterogjen.

Kapitulli i dytë, ka për bazë gjendjen e Jugosllavisë gjatë Luftës së Dytë Botërore, si një shtet i ndarë nga lufta. Kolapsi politik dhe ai ushtarak do të vinte si rezultat i veprimtarisë së dobët

diplomatike dhe i ndikimit të huaj mbi qeverinë, që e bëri atë të paralizueshme nga agresioni i huaj. Pushtimi i forcave të Boshtit tregonte sa shumë probleme të brendshme kishte Jugosllavia dhe sa të dobëta i kishte marrëdhëniet me shtetet fqinje. Në këtë kapitull do të kushtohet rëndësi trajtimit të zonave të pushtimit nga Boshti, lindjes së shteteve kukulla, kolaboracionit, rezistencës dhe çlirimit. Jugosllavia ishte nën një pushtim të huaj dhe në të njëjtën kohë në një luftë civile e cila e bëri situatën shumë të ndërlikuar, duke shpenzuar kohë dhe mund të madh deri në çlirimin e plotë. Ndasitë historike midis grupeve etnike do të dërgonin në lindjen e lëvizjeve të armatosura të rezistencës që më vonë do të merrnin kontrollin mbi të gjithë territorin dhe njëra nga to do të drejtonte me shtetin në periudhën e pasluftës.

Në kapitullin e tretë, shpalosën ngjarje si shëndërrimi i shtetit nga monarkia në federatë, periudha e socializmit dhe pozita ndërkombëtare e Jugosllavisë. Me mbarimin e luftës u bë një riorganizim i tërësishëm politik dhe administrativ duke u mbështetur në mënyrën e funksionimit të shteteve socialiste. Ndryshimet e mëdha në shoqëri, planet ekonomike dhe uniteti ishin veçantitë e një tentative të re për ta mbajtur Jugosllavinë të bashkuar. Një shtet që funksiononte nga lartë poshtë dërgonte në reforma të mëdha dhe bindje të plotë ndaj institucioneve. Titoizmi do të ishte kursi politik që Jugosllavia do të rrugëtonte gjatë Luftës së Ftohtë. Duke shfrytëzuar pozitën gjeografike dhe marrëdhëniet me dy blloqet, Jugosllavia do të bëhej lidere e grupit të Painkuadruarve, që asaj do ti sillte prestigj dhe ndikim më të madhë në politikën botërore, që pastaj do të përkthehej në të mira ekonomike. Ndryshimet e shpeshta kushtetuese dhe fillimi i librealizmit i ndjekur nga decentralizimi shërbeu në kontrollimin dhe barazinë e rivalitetit midis republikave. Këto vite të mira që kishin bërë federatën të njohur në botë do të pasoheshin nga kriza e modernitetit socialist e cila përfshiu të gjitha qeveritë lindore.

Kapitulli i katërt, njëkohësisht dhe i fundit paraqet krijimin dhe mbështetjen e një shteti rreth një njeriu, rritjen e ndjenjave kombëtare të përcjellura nga kriza ekonomike dhe rënien e socializmit nëpër botë. Lëshimet administrative, korrupsioni, dhe problemet e natyrave të ndryshme do të qonin në fillimin e fundit të asaj që më parë nihej si “mrekullia ballkanike”. Rikthimi i dominimit të serbëve mbi popujt e tjerë ishte ndër shkaktarët kryesorë të shkatërrimit të Jugosllavisë dhe fillimit të luftrave për pavarësi. Vitet e 90-ta qenë dëshmitare se çfarë fuqie kishte nacionalizmi ndërmjet popujve që kishin bashkëjetuar me dekada me njëri tjetrin. Trajtimi

i luftës midis popujve jugosllavë, ndikimi ndërkombëtarë dhe fundi i përhershëm i Jugosllavisë përbën pikat kryesore të këtij kapitulli.

Në fund të këtij punimi të diplomës do të jepen përfundimet e arritura pas hulumtimit dhe studimit të kësaj teme.

Për ta finalizuar këtë punim është përdorur metodologjia më e avancuar shkencore, duke ndjekur metoda të ndryshme të kërkimit shkencor si dhe të qasjes, kronologjike, tematike, analitike dhe krahasimtare. Bibliografia e këtij punimi, si pjesë e pandarë e shkencës historike karakterizohet nga një shumëllojshmëri burimesh. Burimet arkivore i kanë dhënë temës një qasje dukshëm më serioze, të pasuara nga literatura relevante dhe publikimet shkencore.